



STATUTI I SHOQERISE

"INTECH+" SH.P.K. SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

TITULLI

Neni 1:

ILIR BEQAJ, i biri i Hamitit, i datelindjes 1968, lindur dhe banues ne Tirane, me adrese: Rr."Pjeter Bogdani" P.20/4 ap.7c, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. 028401216

SOKOL SINANI, i biri i Beharit, i datelindjes 1968, lindur dhe banues ne Tirane, Pallatet "Agimi", Sh.19/337, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. 029231869, jemi ortakët, themelues te shoqerise te emertuar "INTECH+" SH.P.K., dhe jemi njohur me ane te vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 26596 date 01.11.2001, kemi marre vendimin e ortakëve te shoqerise date **19.05.2011**, ne zbatim te ligjislacionit Shqiptar e posaçerisht te Ligjit me Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" te beje ndryshimet e duhura per zhvillimin e qete e korrekt te veprimtarise se shoqerise "INTECH+" SH.P.K., - Tirane.

Neni 2: Objekti

Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

1.1

- Tregtim i sistemeve kompjuterike per Perpunim Informacioni dhe Transmetim
- Prodhim i programeve aplikative
- Instalimi i sistemeve te Informacionit dhe te Nderlidhjes
- Sherbim i sistemeve elektronike ne cdo fushe te ekonomise
- Tregtimi i pajisjeve dhe sistemeve elektronike ne cdo fushe te ekonomise
- Aktivitete te tjera, qe vecmas ose sebashku me ato te mesipermet, do te konsiderohen te papërshtatshme per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise

1.2. Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesëmarrje me kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndërmarrje te tjera.

Neni 3: Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise Tregtare "INTECH+" SH.P.K., eshte e pakufizuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 4: Selia, struktura juridike, administrimi, hapësira ne internet dhe adresa Elektronike

Selia e e Shoqerise Tregtare "INTECH+" SH.P.K., eshte ne adresen, Rr."Deshmoret e 4 Shkurtit", Kompleksi "Parku Jeshil", Kulla 2, Ap.1, Tirane. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise si dhe jashte saj.

Per kete ajo mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithë territorin e R.SH., si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

(1) Atributet e shoqerise do te kryhen nga ortakët e shoqerise te cilet miratojne llogarite nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar marrin vendime per ndryshimet qe mund te pesoje statuti per ndryshimin e mases se kapitalit fillestar dhe shndrrimin e shoqerise ne nje forme tjetër per punesimin e punonjesve dhe pagat e probleme te tjera ne zbatim te ligjislacionit shqiptar. Vendimet e marra, evidentohen ne nje regjister dhe nje kopje e tyre depozitohet prane (Q.K.R.) qendres kombetare te regjistrimit.

(2) Adresa e Shoqerise per qellimin e komunikimit elektronik eshte si vijon:



- (a) Shqiperi tel. +355 4 2241929
(b) Email: intech@intech-al.com

TITULLI II Kapitali

Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit fillestar

- (1) Kapitali aktual i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "INTECH+" SH.P.K., eshte 12,000,000 leke (dymbedhjete milione) dhe eshte i ndare ne 100(njeqind) kuota te te njejes madhesi, me vlere nominale 120,000 leke per çdo kuota.
Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj sipas vendimit te ortakeve.
- (2) Kontributi i Ortakeve themelues ne kapitalin themeltar ne perputhje me kontributin:

Ilir Beqaj	zotëron	51 % te pjesëve te kapitalit
Sokol Sinani	zoteron	49% te pjesëve te kapitalit

- (3) Kontributet e mesiperme jane shlyer teresisht.

Neni 6: Kerkesa per te paguar kuotat e kapitalit dhe terheqja e kuotave te papaguara

- (1) Administratori mund t'i kerkoje ortakeve, te paguajne kontributin e papaguar ne lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, ne varesi te marrjes se njoftimit prej te pakten, katermbedhjete ditesh te plota, qe percakton kohen dhe vendin se ku duhet te behet pagesa, i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e veta, si percaktohet ne njoftim. Thirrja per pagese mund te kerkoje qe pagesa te behet me keste. Personit te cilit i drejtohet thirrja per pagesen e kontributit pergjigjet per thirrjet qe i behen pavaresisht kalimit te mepasshem te pronesise se kuotave me te cilat behet thirrja per pagese.
- (2) Zoteruesit e perbashket te nje kuote, mbajne pergjegjesi bashkarisht dhe vecmas per te shlyer te gjitha thirrjet per pagese te kontributit, te cilat lidhen me kete kuote.
- (3) Nese nje thirrje per pagese mbetet e papaguar pas mbarimit te afatit, Administratori mund t'i jape nje njoftim prej jo me pak se katermbedhjete ditesh te plota personit qe eshte pergjegjës per pagesen, permes te cilit i kerkojne te paguaje shumen e papaguar se bashku me interesin qe mund te jete akumuluar. Ne njoftim jepet emri i vendit ku duhet bere pagesa dhe ne te deklarohet se nese nuk zbatohet, kuotat e pronesise me te cilat lidhet njoftimi, pergjigjen duke u anuluar.
- (4) Nese njoftimi nuk zbatohet, kuota me te cilin lidhet njoftimi, perpara se te behet pagesa e kerkuar nga njoftimi, mund te terhiqet me vendim te Administratorit dhe terheqja perfshin edhe te gjithë dicidentet ose shumat e tjera te pagueshme ne lidhje me aksionet e terhequra dhe te papaguara deri ne momentin e terheqjes.
- (5) Ne varesi te parashikimeve te Ligjit, nje kuote e terhequr mund te shitet, rishpermdahet ose te hiqet ne baze te kushteve dhe menyres qe konsiderohet e arsyeshme nga administratori.
- (6) Personi prej se cilit jane terhequr kuotat e kapitalit, pushon se qeni ortak me kuotat e terhequra, por vazhdon te jete pergjegjës perpara shoqerise per te gjitha kontributet te cilat jane te pashlyera ne daten e terheqjes se kuotave ne lidhje me keto kuota se bashku me interesin e llogaritur me normen e interesit te zbatueshem per keto kontribute perpara terheqjes.

Neni 7: Kuotat, te drejtat dhe kufizimet

Ne varesi te dispozitave te Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuota mund te emetohet me te drejta ose kufizime te tilla siç percaktohet ne vendimin e kualifikuar te kapitalit te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 8: Çertifikata e kuotave te kapitalit

Ortaket ne momentin e marrjes se pronesise se kuotave te kapitalit, fitojne te drejten te marrin pa pagese nje çertifikate per te gjitha kuotat qe zoterojne. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje çertifikate per kuotat ne zoterim te perbashket te disa personave dhe dhenia e çertifikates perfaqesuesit

Te zoteruesve të perbashket sipas neni 72, paragrafi(2) të Ligjit, perben nje dhenie te mjaftueshme per te gjithë keta zoterues. Emrat e zoteruesve të perbashket renditen ne çertifikaten e kuotes. Ky vendim nuk ka natyren e letres me vlere.

Neni 9: Kalimi i kuotave me kontrate

- (1) Kontrata e kalimit të kuotes behet me shkrim dhe ne baze të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotes i njoftohet selise së regjistruar të Shoqerise.
- (2) Administratori mund të mos pranojë të regjistrojë kalimin e kuotes prane QKR-se, nese kuota nuk është shlyer teresisht ose nese nuk janë dakord që kuoten të marrë marresi.
- (3) Nese administratori nuk pranon të regjistrojë kalimin e kuotes, ata, brenda një muaji pas dates ne të cilen është bere kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqeri, i dergojnë marresit njoftimin për mospranim.

Neni 10: Kalimi përmes trashëgimise ose falimentimit

- (1) Nese ortakut/(nje ortak vdes), bashkezoteruesit e mbetur gjalle dhe, ne rastin kur është zoterues i vetem ose nje bashkezoterues i vetem i mbetur gjalle, trashëgimtaret e tij, janë të vetmit persona, të cilët shoqeria i njeh si titullare të kuotes së tij. Por, asnjë dispozite e ketushme, nuk e çliron pasurine e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuoten që ka pasur në zotërim të vetem ose bashkarisht.
- (2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuote si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortakut ose ortakut të vetem, mundet që pas paraqitjes së provave të kerkuara nga Administratori, të vendosë ose të behet zoteruesi i kuotes ose të kerkojë që si zoterues i kuotes të regjistrohet një person tjetër i caktuar për tij. Nese vendos të behet zoterues vete, ai e njofton shoqerine në lidhje me kete. Nese vendos që të kerkojë që si zoterues i kuotes të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotes tek ky person tjetër.
- (3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuote si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortakut gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qene si zoterues i kuotes, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet prane QKR-se, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votes në asamblene të shoqerise.

Neni 11: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund t'a zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakut të vetem/ortakeve, me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në kete rast, vendimi duhet të merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% pjesë të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e tij në propocion me pjesët e tyre në kapital. Kapitali aktual i Shoqerise me Përgjegjesi të Kufizuar "INTECH+" SH.P.K., është 12,000,000 leke (dymbëdhjetë milionë) dhe është i ndarë në 100(njëqind) kuota të të njëjtes madhësi, me vlerë nominale 120,000 leke për çdo kuote.
- (2) Me anë të vendimi të kualifikuar, shoqeria mund t'a zvogelojë kapitalin e vet. Në kete rast, vendimi duhet gjithmone të merret me votën pro të 100 % të të gjithë ortakëve të shoqerise, apo me votën pro vetem të ortakëve të pranishëm. Në çdo rast, kapitali i shoqerise nuk mund të zvogelohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

Neni 12: Bierja e kuotave nga ortakët dhe të tjerët

Ortakët e shoqerise kanë përparësi për blerjen e pjesës që shitet përpara personave të tretë jashtë shoqerise. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim asamblese, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjte me atë që do t'i ofrohet edhe një

B

S

person! te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e blesesit. Ortaku jep oferten brenda 60 diteve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetoje ortakeve te tjere kete kerkese dhe ortaket e tjere duhet te japin nje pergjigje brenda 60 diteve. Edhe e drejta e perparise, duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblese.

E drejta e perparise eshte proporcionale me kuotat e secilit prej ortakeve, por nese nje ortak nuk eshte i interesuar, tjetri mund t'i bleje kuotat qe shiten.

Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 diteve, brenda 30 diteve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij, vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjitha ose pjeserisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqerise, atehere keto kuota brenda 60 diteve i ofrohen personave te trete jashte shoqerise.

Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet te behet me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e ortakeve.

Neni 13: Librat e shoqerise

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje dokumentacionin kontabel Librin e shoqerise ne te cilin shenohen veprimtarite ekonomike, marredheniet e punes, emri i plote i ortakeve, kapitali themeltar si dhe vendimet e ortakeve.

KAPITULLI III Asambleja e Pergjithshme

Neni 14: Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

- (1) Administratori mund te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme kur ta mendoje te asryeshme vete dhe duhet te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme sa here ta kerkojne ortaket ne perputhje me Nenin 84 -te Ligjit.
- (2) Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje bendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjitha ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- (3) Mosveprimi i paqellimte per dhenien e njoftimit per mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit per mbledhjen nga persona qe kane te drejten per ta marre nje njoftim te tille, i ben te pavlefshme punimet e mbledhjes, nese shoqeria nuk provon se personi qe nuk e ka marre njoftimin i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

Neni 15: Kuorumi

- (1) Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendos per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ketij ligji, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3, te nenit 88 te ketij ligji.
- (2) Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne piken 1 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

Neni 16: Emerimi, shkarkimi, te drejtat dhe detyrimet

- Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise . Afati i emerimit i cili caktohet ne statut, nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet me te drejte ripertesitje.
- Administratoret kane te drejte e detyrohen te :
 - a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, suke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.
 - b) Perfaqesojne shoqerine tregtare.
 - c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te

shoqerise.

- c) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- d) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- Dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- e) Raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- f) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- Ne rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 te nenit 82 te ketij ligji, administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme.
 - Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkarisht shoqerine. Statuti ose rregulloret e tjera te miratuara nga asambleja e pergjithshme, mund te parashikojne ndryshe.
 - Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

(2)

Neni 16: Votat e ortakeve

- (1) Ne varesi te te drejtave ose kufizimeve te lidhura me kuotat, secila kuote e nje ortakut i cili (si individ) eshte i pranishem vete ose permes nje prokure perfaqesimi ose (si shoqeri) eshte i pranishem permes perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt ose permes nje prokure perfaqesimi ka te drejten e nje vote.
- (2) Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme personalisht ose permes nje prokure perfaqesimi, ne lidhje me kuotat qe zoteron vete, nese nuk jane paguar teresisht kontributet nga ana e tij ne lidhje me kuoten ne fjale.
- (3) Kundershtimet e ngritura per plotesimin e kushteve nga ana e nje votuesi i behen ne kohe Kryetarit, vendimi i te cilit eshte i formes se prere. Te gjitha votat e pahequra ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre jane te vlefshme.


Neni 17: Hetimet e Posacme

Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin ose zevendesimin e nje audituesi te posacem sipas Nenit 91 te Ligjit e bejne nje kerkese te tille permes depozitimit ne seline e shoqerise te nje dokumenti se bashku me nje deklarate noteriale e cila verteton se personi ose personat i plotesojne kushtet per kete veprim.

KAPITULLI IV Administratori

Neni 18: Emerimi i Administratorit

- (1) Asambleja e Pergjithshme emeron nje person fizik si administrator te vetem te shoqerise per 5 (pese) vjet sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 te Ligjit. Emerimet i nenshtrohen individuailisht nje vendimi me voten pro te shumices se zakonshme, te kapitalit themelues, nese miratohet, çon ne zgjedhjen e personit te propozuar si administrator.
- (2) Kufizimet ne lidhje me emerimin e administratorit parashikohen ne Nenin 95, paragrafi (2) i Ligjit.
- (3) Shoqeria do te drejtohet nga Administratori i zgjedhur nga mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme, i cili emerohet ne kete detyre per nje periudhe kohore 5(pese)vjefare, me te drejte riemerimi.



Neni 19: Administratori

Administrator i shoqërisë "INTECH+" SH.P.K., është z. Sokol Sinani, mbajtës e kartës së identitetit Nr. 029231869, i cili do të ushtrojë detyrën e Administratorit për një periudhë 5 (pese) vjeçare me të drejtë rimerimi.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për gabime e faje të kryera gjatë administrimit.

Neni 20: Kompetencat e Administratorit

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblese së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit (6). Administratori ka keto të drejta dhe detyrime:

- te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- te përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me leshimin e prokurave, mandateve të veçanta për avokate, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarreveshje; të leshojnë ose të revokojnë mandate *ad lites* avokateve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose me shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;
- te kryejë çdo operacion financiar dhe/ose tregtar (kontrata *leasing*, operacione cedimi kredie) aktive dhe pasive, që ka lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përbushje të formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dorezaninë,
- te çelin llogari rrjedhese bankare, të kryejë terheqje parash, të japë dispozita të pageses, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek keto llogari rrjedhese, edhe të zbuluar, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (*overcover*), të verifikojë keto llogari rrjedhese dhe të miratojë llogarinë;
- të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;
te nderveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- të leshojë ekstrakte të borderove dhe vertetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përbushjeve, ndaj të cilave shoqëria është e detyruar, me të drejtën për të nënshkruar deklarata tatimore, që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;
- të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësime nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkallë, me të drejtën për të emeruar mbrojtës të posaçëm;
- të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e koncesioneve, licencave dhe lejeve, duke emeruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;
- të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhese dhe ekstrakteve periodike të llogarive rrjedhese për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;
te nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë; të ndertojë, të perfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakord mbi afatet dhe kushtet;
te kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumentave të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomes së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të

tjera;

te perfaqesojë shoqëri në asamblë të shoqëri të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto entë, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emerojë perfaqësues, të delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij. (2) Administratori mund të delegojë kompetencat e tij komitetëve që përbehen nga një ose më shumë anëtarë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varesi të kushteve që mund të vendosë Administratori dhe mund të revokohet ose të ndryshohet.

(3) Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktive nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të kishin qenë të vlefshme, nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.

(4) Administratori nuk mund të delegojë asnjëherë prej detyrimeve, të cilat ia ngarkon ligji.

Neni 21: Skualifikimi dhe largimi i administratorit

(1) Posti i Administratorit lirohet nëse:

1. Pushon që qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë Nenin 95 paragrafi(6).
2. hyn në procedurën e paafetisë paguese;
3. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
5. ka munguar për më shumë se tre muaj radhazi pa lejen në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë ose Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Ortakëve të tjerë vendos të lirojë.

Neni 22: Shperblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

- (1) Administratori ka të drejtë të marrë shperblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar me parë për shoqërinë, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkeshortin, bashkeshorten, ish-bashkeshortin ose ish-bashkeshorten) ose për persona të cilët janë në varesi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dënimin e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu edhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).

Neni 23: Vendimet e Mbledhjeve të Administratorit

- (1) Mbledhjet e administratorit mbahen sa herë të kërkojë aktiviteti i shoqërisë.
- (2) Të gjitha aktet e kryera nga Administratori ose nga një person që ushtron detyrën e caktuar nga Administratori, pavaresisht faktit nëse me vone zbulohet se ka pasur mangësi në emerimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka pasur të drejtë vote, janë të vlefshme nëse sikur të gjithë këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin Administrator.

Neni 24: Kufizimet për votimin

- (1) Një Administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime për asnjë çështje në të cilën ka, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjere ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 të Ligjit, nëse me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:

1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
2. të autorizojnë të vendosë për çështjen në fjalë.

Autorizimi mund të jete i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

- (2) Nje Administrator nuk konsiderohet si pjesetar i kuorunit te pranishem ne nje mbledhje ne lidhje me nje vendim per te cilin nuk ka te drejte vote. Per perjashtimin e Administratorit nga marrja e vendimit ne nje mbledhje te tille zakonisht zbatohet perkatesisht Neni 89 i Ligjtit.

Neni 25: Proçesverbalet e Mbledhjeve te Administratorit

- (1) Administratori kujdeset qe ne librat te posaçem te mbaje proçesverbalet e te gjitha takimeve te bera nga Administratori.
- (2) Te gjitha punimeve te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme dhe mbledhjeve te Administratorit dhe te komiteteve te krijuara nga Administratori, perfshire edhe emrat e personave te ftuar te pranishem ne keto mbledhje.

KAPITULLI V

Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve

Neni 26: Dividentet

- (1) Pas permbushjes se kerkesave te nenit 77 te Ligjit, shoqeria, me ane te nje vendimi te kualifikuar, mund te shpalle dividente ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakut/ortakeve.
- (2) Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe u lidhen kuotave, te gjitha dividentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat gjate pjeses ose pjeseve te periudhes ne lidhje me te cilat paguhet dividenti. Por, nese kuotat emetohen me kushtin se merr divident, duke filluar nga kjo date e caktuar ateherë kuota ne fjale e merr dividentin sipas ketij kushti.
- (3) Asnje divident dhe asnje mjet monetar i pagueshem ne lidhje me nje kuote nuk mund te fitoje interesa nga shoqeria nese nje gje e tille nuk parashikohet ne te drejtat qe i lidhen kuote.
- (4) Nese nje divident nuk eshte terhequr pas dymbledhjeve vjeteve nga data kur mund te terhiqet pagesa, nese Asambleja e Pergjithshme vendos me vendim te kualifikuar, ky divident mund te anulohet dhe shoqeria nuk eshte e detyruar ta paguaje.

Neni 27: Kapitalizimi i fitimeve

Me autoritetin qe i jep nje vendim i kualifikuar i Asamblese se Pergjithshme dhe duke pasur ne konsiderate parimet e vendosura nga neni 14 i Ligjit, Administratori/ret mund te vendose te kapitalizojë fitimet e shperndara te shoqerise qe nuk kerkohen per te paguar dividente preferenciale ose borxhe te tjera te shplyera ende nga shoqeria dhe kapitali i detyruar i shoqerise.

KAPITULLI VI
Prishja dhe Njoftimet

Neni 28: Prishja dhe Likuidimi

Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesit me autoritetin qe i jep nje vendim i kualifikuar i Asamblese se Pergjithshme dhe ne perputhje me Ligjin, mund t'i shperndaje ortakut/ortakeve te gjitha vleren ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim mund t'i vleresojë pasurite dhe te percaktojë se si te behet nje shperndarje e tille midis ortakut/ortakeve.

Neni 29: Njoftimet

- (1) Njoftimet qe i jepen personave ose qe bejne personat sipas Statutit, duhet te jene me shkrim ose permes komunikimit elektronik ne adresen elektronike, e parashikuar ne Nenin 4 te ketij



- (1) Statuti, qe eshte i vlefshem ne momentin qe i behet e ditur per kete qellim personit qe beri njoftimin.
- (2) Shoqeria mund ti jape nje njoftim ortakut/nje ortakut ose personalisht ose duke ja nisur me poste ne nje zarf per te cilin eshte paguar edhe kthimi i pergjigjes ne adresen e regjistruar te ortakut ose duke ia lene ne kete adrese ose duke ia dhene permes komunikimit elektronik ne adresen qe eshte e vlefshme per momentin dhe i eshte bere e ditur shoqerise nga ana e ortakut. Kur ka bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te bashkezoteruesve ne perputhje me Nenin 7, paragrafi(2) te Ligjit.
- (3) Ne kete Statut, perfshihen shtesa dhe ndryshime dhe te gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikatat dhe proces-verbalet e shoqerise, vendosen nga Administratori ne hapesine ne internet te shoqerise te parashikuar ne Nenin 4, te ketij Statuti.

Neni 30: Dispozita te Pergjithshme

Per ceshtje probleme apo procedura qe nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut, vlejne dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" seksioni per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

Selia e shoqerise duhet te kete te mbishkruar pas kesaj te paktin emrin e shoqerise, numrin e vendimit dhe vitin e inkorporimit dhe fjalet "Vula e shoqerise".

Qdo mosmarreveshje qe del nga kjo marreveshje do te caktohet para Gjykates se Rrethit Tirane (vendit) ku ndodhet zyra e regjistruar e shoqerise.

Neni 31: Dispozita Perfundimtare

Ky Statut perpilohet ne 4(kater)kopje, ne gjuhen shqipe me fuqi te njejte ligjore. Statuti mbyllet me 31 (tridhjetete e nje)nene.


Ky statut do te hyje ne fuqi menjehere me regjistrimin e tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Statuti u miratua dhe u nenshkrua nga ortakët themelues sipas ligjit.


Tirane date 21.05.2011.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "INTECH+" SH.P.K.

Ilir BEQAJ



Sokol SINANI



Notere Majlinda Lleshi
Dhoma e Noterise Tirane
Rr" Sulejman Delvina "
Tel ++2234555
Nr 1981 Rep
Nr 639 Kol

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne date 21.05.2011 (dymije e njembdhjete) ne Tirane, para meje
Noteres **Majlinda Lleshi** Notere ne Dhomen e Noterise Tirane me zyre ne
Rr" Sulejman Delvina", u paraqiten personalisht :

Z. Ilir BEQAJ i biri i Hamitit, i datelindjes 1968, lindur dhe banues ne Tirane,
madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar
nepermjet Leternjoftimit ID Nr 028401216,

Z. Sokol SINANI i biri i Beharit, i datelindjes 1968, lindur dhe banues ne Tirane,
madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar
nepermjet Leternjoftimit ID Nr 029231869,

te cilet deklaruan se kane nenshkruar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote
Statutin e Shoqerise "INTECH+" sh.p.k. dhe une Noterja, vertetoj nenshkrimin
ne baze te ligjit.

